

8 VITE PAS MARRËVESHJES SË 19 PRILLIT:

CILA ËSHTË GJENDJA E ZBATIMIT?



8 VITE PAS MARRËVESHJES SË 19 PRILLIT:









CILA ËSHTË GJENDJA E ZBATIMIT?

PRILL 2021

PËRMBAJTJA

HYRJE	6
--------------------	----------

GJENDJA E ZBATIMIT TË MARRËVESHJES SË 19 PRILLIT	7
---	----------

 ASOCIACIONI	8
 SIGURIA	9
 GJYQËSORI	10
 ZGJEDHJET	11
 PLANI I ZBATIMIT DHE FINANCIMI.....	12
 ENERGJIA DHE TELEKOMI.....	12
 RRUGA DREJT BE-SË	13
 KOMISIONI I ZBATIMIT.....	13

PËRFUNDIM	14
------------------------	-----------

Layout and design: envinion

E drejta e autorit © 2021. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 239,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +383 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Autore: Violeta Haxholli

Vërejtje: Ky raport është realizuar në kuadër të projektit “Promovimi i një procesi të mirinformuar dhe pjesëmarrës në fazën finale të dialogut Kosovë-Serbi” i mbështetur nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), dhe në asnjë rrethanë nuk do të konsiderohet që reflekton qëndrimet e Ambasadës Zvicerane në Prishtinë.



HYRJE

Dialogu mes Kosovës dhe Serbisë filloi me 8 mars 2011 në Bruksel, pas miratimit të Rezolutës në Asamblenë e Kombeve të Bashkuara, e cila bënte thirrje për një dialog për lehtësimin e jetës së qytetarëve dhe avancimin e dy vendeve drejt BE-së.¹

Në kuadër të fazës së parë të dialogut, e cila definohej si proces teknik, u arritën shtatë konkluzat mes palëve për çështje si lëvizja e lirë, regjistrat civil, regjistrat kadastral, vulat doganore, diplomat, përfaqësimi dhe bashkëpunimi rajonal/fusnota dhe menaxhimi i integruar i kufijve (IBM).²

Në tetor të vitit 2012, procesi i dialogut teknik filloi të referohej si dialog politik pasi në diskutim po përfshiheshin edhe tema tjera. Vetëm disa muaj pas fillimit të kësaj faze u arrit një marrëveshje e rëndësishme e ashtuquajtur Marrëveshja e Parë e Parimeve për Normalizimin e Marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë, me 19 prill 2013 në Bruksel. Marrëveshja u parafua nga dy kryeministrat e asaj kohe Hashim Thaçi dhe Ivica Dačić, nën ndërmetësimin e Përfaqësues së Lartë të BE-së në atë periudhë Catherine Ashton. Marrëveshja u ratifikua edhe në Kuvendin e Kosovës.


Teksti i Marrëveshjes së 19 prillit është i shkruar në 15 pika, gjashtë prej të cilave lidhen me themelimin e një Asociacioni të komunave me shumicë serbe. Në vitet në vijim nga kjo marrëveshje kanë buruar një numër i marrëveshjeve tjera siç ishte marrëveshja për mbledhjen e të hyrave doganore (janar 2013), për Energjinë (shtator 2013), për Telekomin (shtator 2013), për Drejtësinë (shkurt 2015) për shpërbërjen e "Mbrotjes Civile" (mars 2015) dhe për Asociacionin (gusht 2015).

Tetë vite pas arritjes së Marrëveshjes së Parë, shtatë nga pikat e saj janë zbatuar, gjashtë prej tyre të cilat lidhen me Asociacionin nuk janë zbatuar ende, dhe dy prej tyre janë zbatuar pjesërisht.

Në tabelën më poshtë janë të paraqitura pikat e kësaj marrëveshje, gjendja dhe konteskti i zbatimit të saj.

GJENDJA E ZBATIMIT TË MARRËVESHJES SË 19 PRILLIT

Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve (tutje Marrëveshja e Parë)³



¹ Rezoluta e OKB-së për dialogun Kosovë-Serbi në, http://www.un.org/en/ga/search/vieë_doc.asp?symbol=A/RES/64/298
² Shih të gjitha konkluzat në, <http://www.votajme.org/Public/Dialog>

³ Shih marrëveshjen dhe detajet tjera në, http://www.votajme.org/Uploads/Data/Documents/TekstiiMarreveshjes_19prill2013_HGXf5EDTG4.pdf



Pikat e Marrëveshjes	Gjendja e zbatimit	Konteksti
 ASOCIACIONI		
<p>1 Do të krijohet një Asociacion/Bashkësi e komunave me shumicë serbe në Kosovë. Anëtarësimi do të jetë i hapur për çdo komunë tjetër me kusht që anëtarët janë në pajtim.</p> <p>2 Bashkësia/Asociacioni do të krijohet përmes statutit. Shpërbërja e Bashkësisë/Asociacionit mund të bëhet vetëm me vendim të komunave pjesëmarrëse. Do të ofrohen garanci ligjore përmes ligjit të zbatueshëm dhe të drejtës kushtetuese (përfshirë rregullën për shumicën prej 2/3).</p> <p>3 Struktura e Asociacionit/Bashkësisë do të themelohet mbi të njëjtën bazë sikurse statuti ekzistues i Asociacionit të komunave të Kosovës, p.sh. Kryetari, Nënkyetari, Kuvendi, Këshilli.</p> <p>4 Në përputhje me kompetencat e parapara me Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjin e Kosovës komunat pjesëmarrëse do të kenë të drejtë të bashkëpunojnë në ushtrimin e kompetencave të tyre përmes Asociacionit/Bashkësisë në mënyrë kolektive. Asociacioni/Bashkësia do të ketë mbikëqyrje të plotë mbi fushat e zhvillimit ekonomik, arsimin, shëndetësisë, planifikimit urban dhe rural.</p> <p>5 Asociacioni/Bashkësia do të ushtroj kompetenca të tjera shtesë siç mund të delegohen nga autoritetet qendrore.</p> <p>6 Bashkësia/Asociacioni do të ketë rol përfaqësues te autoritetet qendrore dhe do të ketë një ulëse në Këshillin Konsultativ të Komuniteteve për këtë qëllim. Në përbushje të këtij roli është paraparë funksioni monitorues.</p>	<p> E PA ZBATUAR</p>	<p>Me 25 gusht 2015, u arrit edhe marrëveshja specifike mbi Parimet e përgjithshme/Elementet kryesore të Asociacionit/Bashkësisë së komunave me shumicë serbe në Kosovë. Pasi përmbajtja e saj u dërgua në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtim, kjo e fundi konstatoi në Aktgjykimin e datës 23 dhjetor 2015⁴, se Asociacioni themelohet në bazë të Marrëveshjes së Parë marrëveshja, por se parimet e marrëveshjes nuk janë tërësisht në përputhshmëri me frymën e Kushtetutës. Prandaj Gjykata përcaktoi që akti i Qeverisë dhe statuti që implementon parimet duhet të plotësojnë standardet kushtetuese të parapara në këtë Aktgjykim.⁵</p> <p>Në shtator të vitit 2016, qeveria e asaj kohe e udhëqeur nga Isa Mustafa kishte njoftuar se kishte kompletuar Ekipin Menaxhues të përbërë nga përfaqësues të komunitetit serb, i cili do të draftonte statutin e Asociacionit.⁶ Ekipi nuk kishte dorëzuar ndonjë statut të draftuar tek Qeveria e Kosovës, por as në Bruksel.</p> <p>Me 4 prill 2018 ish Qeveria Haradinaj në bashkëpunim me presidentin e asaj kohe Hashim Thaçi, sërisht kishin aktivizuar Ekipin Menaxhues⁷, të cilit iu përcaktua që të draftonte statutin deri me 4 gusht 2018. Mirëpo në tetor të po atij viti, zyrtarë të asaj qeverie kishin deklaruar se nuk kishin informacione nëse ky Ekip kishte dorëzuar statutin në Bruksel pasi tek Qeveria e Kosovës kishte dorëzuar vetëm proces verbale të takimeve.⁸</p> <p>Çështja e themelimit të Asociacionit është riaktualizuar sërisht gjatë qeverisjes së koalicionit LDK-AAK-NISMA nën udhëheqjen e kryeministrit Hoti gjatë pjesës së dytë të vitit 2020 pas takimeve të nivelit të lartë në Bruksel, ku pala serbe kishte kërkuar që kjo temë të diskutohej. Ndërsa, pala kosovare e ka mohuar se kanë ndodhur diskutime lidhur me këtë çështje.</p>


4 Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese për marrëveshjen e Asociacionit në https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjk_ko_130_15_shq.pdf

5 Po aty.

6 Shih lajmin në uebfaqen zyrtare të Kryeministrit të Kosovës në <https://kryeministri-ks.net/komunikate-per-medie-33/>

7 Po aty në <https://kryeministri-ks.net/krijohen-strukturat-e-reja-gjithperفشirese-per-asociacionin-e-komunave-serbe/>

8 Shih Top Channel "Asociacioni i komunave serbe. Qeveria e Kosovës nuk di nëse drafti serb është në duart e BE-së", tetor 2018 në <https://top-channel.tv/2018/10/29/asociacioni-i-komunave-serbe-qeveria-e-kosoves-nuk-di-nese-drafti-serb-eshte-ne-duart-e-be-se/>

Pikat e Marrëveshjes	Gjendja e zbatimit	Konteksti
 SIGURIA		
<p>7 Në Kosovë do të ketë një forcë policore, e quajtur Policia e Kosovës. E tërë policia në Kosovën veriore do të integrohen në kornizën e Policisë së Kosovës. Pagat do të jenë vetëm nga PK-ja.</p> <p>8 Pjesëtarëve të strukturave tjera serbe të sigurisë do t'u ofrohet vend në strukturat ekuivalente të Kosovës.</p> <p>9 Do të ketë një Komandant Rajonal të Policisë për katër komunat veriore me shumicë serbe (Mitrovica Veriore, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi). Komandanti i këtij rajoni do të jetë një serb i Kosovës i nominuar nga Ministria e Punëve të Brendshme nga lista e ofruar nga katër kryetarët e komunave në emër të Bashkësisë/Asociacionit. Përbërja e PK-së në veri do të reflektojë përbërjen etnike të popullatës së katër komunave. (Do të ketë Komandant tjetër rajonal për komunat e Mitrovicës Jugore, Skënderajit dhe Vushtrrisë). Komandanti rajonal i katër komunave veriore do të bashkëpunojë me komandantë tjerë rajonal.⁹</p>	<p> E ZBATUAR</p>	<p>Në raportin e 18 qershorit 2018 Qeveria e Kosovës ka raportuar se kjo pikë e marrëveshjes është zbatuar me disa vonesa.</p> <p>Serbia është dashur të siguroj një listë me numrin dhe gradën e punonjësve qeveritar serb (policë) të punësuar në Kosovë, të cilët kanë shprehur interesimin që t'i bashkohen strukturave të Kosovës (që nga 13 qershori i vitit 2013). Megjithatë, dorëzimi i listës ishte vonuar deri më 11 dhjetor 2013).¹⁰</p> <p>Pas dorëzimit të listës, Kosova bëri ndryshimet ligjore për krijimin e Departamentit Regjional të Policisë Mitrovica dhe emëroi Drejtorin Rajonal të Policisë në Mitrovicën Veriore me anë të udhëzimit administrativ me 22 korrik 2013.¹¹</p> <p>Nga pjestarët e MUP-it për integrim aplikuan gjithsej 337 persona. Pas verifikimi të së kaluarës u aprovuan 292 persona. Prej tyre, 5 u tërhoqën nga procesi i integritimit duke e ndërprerë trajnimin.¹²</p>

9 Marrëveshja e Parë, pika 7.8 dhe 9.

10 Shih raportin e Qeverisë të datës 18 qershor 2018, fq.6, në [http://www.votaim.org/Uploads/Data/Documents/Raportmbiarritjetdhesfidatnezbatimine-MarreveshjeveBrukselit_18qershor2018_GAc6YnWvKU\(1\)_hXwNkAUHPK.pdf](http://www.votaim.org/Uploads/Data/Documents/Raportmbiarritjetdhesfidatnezbatimine-MarreveshjeveBrukselit_18qershor2018_GAc6YnWvKU(1)_hXwNkAUHPK.pdf)

11 Shih këtë udhëzim në https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/184/UA_Nr.12_2013_MPB_PER_ZGJEDHJEN_E_DREJTORIT_RAJONAL_TE_POLICISE_PER_RAJONIN_MITROVICI-VERI.pdf

12 Raporti i Qeverisë, 18 qershor, 2018, fq.6.



Pikat e Marrëveshjes	Gjendja e zbatimit	Konteksti
 PLANI I ZBATIMIT DHE FINANCIMI		
<p>12 Një plan zbatimi, përfshirë afatin kohor, do të nxirret deri më 26 Prill. Parimi i financimit transparent do të adresohet në zbatimin e kësaj marrëveshjeje.</p>	 <p>PJESËRISHT E ZBATUAR</p>	<p>Me 22 maj 2013, palët u dakorduan për planin e zbatimit të Marrëveshjes.¹⁸ Lidhur me parimin e financimit transparent, në këtë plan thuhej se, deri në fund të majit, Serbia do të paraqesë pasqyrën e përgjithshme të detajuar të të gjitha financimeve të institucioneve në Kosovë përmes Komitetit Zbatues. Ndërsa, deri kah mesi i korrikut, nga të dyja palët në Komisionin Zbatues do të definohet metoda e parimeve përmbushëse për financim transparent.¹⁹ Lidhur me këtë çështje në një raport të vitit 2016 Qeveria e Kosovës kishte raportuar se, shërbimet publike lokale kryesisht ofrohen nga strukturat paralele, të cilat politikisht dhe financiarisht mbështeten nga Serbia.²⁰ Ndërsa, në një raport të mëhershëm Qeveria kishte deklaruar se Serbia vazhdon që të ndajë rreth 500 milion euro në vit për strukturat e saja paralele në Kosovë, pa e cekur se a bëhet ky financim në mënyrë transparente siç ishin dakorduar me këtë marrëveshje.</p>

 ENERGJIA DHE TELEKOMI		
<p>13 Diskutimet lidhur me Energjinë dhe Telekomini do të intensifikohen nga të dy palët, dhe do të përfundojnë deri më 15 qershor.</p>	 <p>PJESËRISHT E ZBATUAR</p>	<p>Sipas kësaj pike të Marrëveshjes së Parë diskutimet për energjinë dhe telekomin kishin vazhduar, mirëpo ende nuk janë përmbyllur. Me 8 shtator 2013, u arritën dy marrëveshje specifike, ajo për energjinë dhe për telekomin. Megjithatë, zbatimi i këtyre marrëveshjeve është shoqëruar me sfida, ndërsa ende nuk janë zbatuar plotësisht. Po ashtu Kosova dhe Serbia ende nuk janë dakorduar lidhur me shërbimet postare.²¹ Që nga viti 2017 dialogu në mes delegacioneve lidhur me këtë marrëveshje është ndaluar, ndërsa nuk ka pasur asnjë diskutim lidhur me shërbimet postare pavarësisht që është përcaktuar ndryshe me marrëveshje. Ndërsa, lidhur me energjinë ende ka çështje kontestuese mes dy palëve siç është kontrolli i nënstationit të Vallaçit, gjë që pengon normalizimin e situatës së energjisë në pjesën veriore të Kosovës.²²</p>

18 Shih Planin e Zbatimit të Marrëveshjes të arritur me 22 maj 2013 në, http://www.votaim.org/Uploads/Data/Documents/PlaniZbatues_22maj2013_DHn8XcsWE3.pdf



19 Po aty.



20 Shih raportin e Qeverisë të vitit 2016 në, http://www.votaim.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbiGjendjenZbatimineMarreveshjeveBrukselit_1janar-15qershor2016_4hMDtBcLH.pdf

21 Shih raportin e Qeverisë të vitit 2015, fq.26 në, http://www.votaim.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbiGjendjenZbatimineMarreveshjeveBrukselit_mars-shtator2015_dn84pp2wew.pdf

22 Shih raportin e Qeverisë të vitit 2015, fq.16 në http://www.votaim.org/Uploads/Data/Documents/RaportmbiGjendjenZbatimineMarreveshjeveBrukselit_1tetor2014-20mars2015_g6Kd8G5Lbb.pdf



Pikat e Marrëveshjes	Gjendja e zbatimit	Konteksti
 RRUGA DREJT BE-SË		
<p>14 Është arritur pajtimi që asnjëra palë nuk do të bllokohet, apo inkurajojë të tjerët të bllokohen, progresin e palës tjetër në rrugët përkatëse drejt BE-së.</p>	 <p>E ZBATUAR</p>	<p>Kosova dhe Serbia gjenden në dy stade të ndryshme të rrugëtimin e tyre drejt BE-së. Kosova është kandidat potencial për antarësim në BE dhe deri më tani ka arritur vetëm të lidhë marrëdhënie kontraktuale me BE-në, përmes nënshkrimit të MSA-së në vitin 2014. Edhe këtë dokument Kosova e ka nënshkruar me fusnotë duke qenë se 5 shtete anëtare të BE-së ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Ndërsa, Serbia ka statusin e shtetit kandidat dhe është duke negociuar kapitujt e antarësimit me BE-në.²³ Në raportet periodike për shtetet e Ballkanit, Komisioni Evropian ka cekur vazhdimisht që normalizimi i marrëdhënieve është parakusht për avancimin e integritimit të Kosovës dhe Serbisë në BE.</p>

 KOMISIONI I ZBATIMIT		
<p>14 Do të themelohet një komision zbatimi nga të dy palët, me lehtësimin e BE-së.</p>	 <p>E ZBATUAR</p>	<p>Palët u dakorduan mbi parimet e organizimit të këtij komisioni në Planin e Zbatimit të arritur me 22 maj 2013. Komisioni përbëhet nga përfaqësues nga të dy palët nën lehtësimin e BE-së. Sipas planit ky komision do të mbikëqyrë zbatimin e pikave të Marrëveshjes së Parë.</p>

23 Shih më shumë në, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/countries/detailed-country-information/serbia_en



PËRFUNDIM

Tetë vite pas arritjes së Marrëveshjes së Parë të Parimeve për Normalizmin e Marrëdhënieve, e arritur mes Kosovës dhe Serbisë me 19 prill 2013 në Bruksel, shtatë pika të kësaj marrëveshje janë zbatuar, dy pika janë zbatuar pjesërisht, ndërsa gjashtë pika të marrëveshjes ende nuk janë zbatuar. Nga Marrëveshja e 19 prillit kanë derivuar edhe një sërë marrëveshjesh tjera të dialogut për çështje si mbledhja e të hyrave doganore, energjia, telekomi, drejtësia, shpërbërja e mbrojtjes civile dhe asociacioni. Kjo e fundit është edhe çështja kryesore e Marrëveshjes së 19 prillit, e cila ende mbetet e pazbatuar. Që nga arritja e marrëveshjes specifike për këtë temë në gusht të vitit 2015 dhe aktgjykimin të Gjykatës Kushtetuese, qeveritë e njëpasnjëshme në Kosovë kanë ndërmarrë hapa për zbatimin e kësaj marrëveshje. Ish qeveria e udhëhequr nga Isa Mustafa kishte krijuar Ekipin Menaxhues në vitin 2016, i cili kishte për detyrë hartimin e statutit të Asociacionit. Pasi statuti nuk ishte përfunduar gjatë asaj periudhe, qeveria pasardhëse e udhëhequr nga Ramush Haradinaj sërish kishte aktivizuar këtë ekip. Njoftimet zyrtare të kësaj qeverie kanë qenë se Ekipi nuk ka dorëzuar statutin në Qeveri dhe se nuk dihet nëse i njëjti i është dorëzuar Brukselit. Çështja e Asociacionit është riaktualizuar si temë edhe gjatë qeverisë së udhëhequr nga Avdullah Hoti. Pas takimeve të mbajtura në Bruksel në kuadër të diskutimeve mbi elementet e marrëveshjes finale Kosovë-Serbi, pala serbe kishte kërkuar që çështja e Asociacionit të diskutohej, ndërsa pala kosovare nuk kishte pranuar një gjë të tillë. Në anën tjetër Bashkimi Evropian si lehtësues i procesit të dialogut, ka kërkuar që Kosova të gjejë modalitete për themelimin e Asociacionit duke mos e qartësuar se çfarë do të thotë saktësisht kjo.

Me rënien e Qeverisë Hoti në fund të vitit 2020 mbeti e paqartë se si do të procedohej tutje me këtë çështje. Ndërsa pas zgjedhjeve të reja qeveria e re tani udhëhiqet nga kryeministri Albin Kurti. Ky i fundit nuk e ka bërë të qartë se cila do të jetë qasja e Qeverisë ndaj dialogut në përgjithësi, përveç se ka deklaruar se do të jetë një qasje ndryshe ndaj këtij procesi dhe se dialogu nuk është prioritet i qytetarëve. Ajo që është e qartë është që tema e dialogut do të jetë sfidë edhe për Qeverinë e re, e cila duhet që sa më parë të artikulojë një qëndrim të qartë ndaj temave të dialogut dhe marrëveshjeve tashmë të arritura, duke përfshirë edhe Marrëveshjen e 19 prillit, e cila është ratifikuar në Kuvendin e Kosovës.





Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA